



Ministri Vengu: Buxheti 2025, garanci financiare për modernizim, investim dhe trajtim dinjitoz të FA-së



Bashkëpunim në rast emergjencash, ministri Vengu prezanton në Kuvend marrëveshjen me Slloveninë

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu prezantoi në Komisionin Parlamentar të Politikës së Jashtme projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Sllovenisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në Mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”.

Kjo marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e emergjencave civile do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e mëtejshme të kapacitetit dhe reagimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera. Sipas marrëveshjes, kjo ndihmë e ndërsjelltë mund të përfshijë ekipe shpëtimi dhe ekspertë individualë, pajisje mbrojtëse dhe shpëtimi dhe ndihmë humanitare. Për të siguruar një ndihmë më të shpejtë dhe më të efektshme në mbrojtje dhe shpëtim dhe në eliminimin e pasojave të një fatkeqësie, në bazë të kësaj marrëveshjeje, palët do t’u japin ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë që ofrojnë ndihmë një procedurë të thjeshtuar për kalimin e kufirit shtetëror, duke marrë parasysh kushtet e aplikueshme të hyrjes.

Po ashtu në marrëveshje përcaktohet se avionët dhe anijet mund të përdoren për transport emergjent të ekipeve të shpëtimit ose ekspertëve individualë që ofrojnë pajisje ndihme, mbrojtjeje, shpëtimi dhe lloje të tjera të ndihmës në përpunje me këtë marrëveshje. Ndërsa përdorimi i avionëve ushtarakë dhe anijeve ushtarake për qëllimet e kësaj marrëveshjeje lejohet vetëm në marrëveshje me shtetin pritës. Marrëveshja pritet të ratifikohet në seancë plenare.



Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në DVD e stërvitjes “SAR Response - 2024”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë e Ditës së Vizitorëve të Shquar të Stërvitjes “SAR Response - 2024”. Në këtë ceremoni ishin gjithashtu të pranishëm përfaqësues të institucioneve të përfshira në këtë stërvitje, gjeneralë, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, si dhe njësitë e FARSH-së të përfshira në këtë stërvitje ndërinstitucionale.

Qëllimi i stërvitjes “SAR Response 2024”, ishte testimi i bashkëpunimit, koordinimit dhe rritjes së aftësive operacionale të të gjitha strukturave që kanë deklaruar kapacitete operacionale sipas Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në RSH, në funksion të përballimit të operacioneve SAR.

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën e rastit adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë pjesëmarrësit në këtë stërvitje, që me angazhimin dhe përkushtimin e tyre kurorëzuan me sukses këtë stërvitje ndërinstitucionale.

“Në rolin e Koordinatorit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit, vlerësoj se kjo stërvitje konsolidoi më tej bazat për koordinimin dhe bashkëpunimin me gjithë institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore, aplikimin e rekomandimeve dhe praktikave më të mira të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, organizatave ndërkombëtare detare, ligjeve kombëtare dhe konventave ndërkombëtare, për përballimin me sukses të operacioneve të kërkim-shpëtimit. Metodologjia e qasjes gjithëpërfshirëse e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (QKKSH), si autoriteti më i lartë kombëtar për drejtimin e koordinimit e operacioneve SAR në RSH, me shtetë fëmijë dhe komitetin rajonal të kërkim-shpëtimit aeronautik, nuk mund të jetë efektive në rast se nuk do të mbështetet në kohën dhe vendin e duhur, me forcat e mjetet e kërkuara



nga QKKSH për institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore e të materializuara në Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit...”, - theksoi gjeneralmajor Kingji.

SHSHPFA, gjatë fjalës së tij nënvizoi gjithashtu faktin se në këtë stërvitje testimi i aftësive planëzuese, koordinuese dhe ato të komandim-kontrollit në operacionet SAR, në një mjedis të tillë operacional, ka në fokus edhe reduktimin e kohës së reagimit, ku në këtë stërvitje u realizua edhe testimi i mjeteve të radio-komunikimit, testimi i procedurave gjatë zhvillimit të operacioneve SAR në incidentet ajrore, detare dhe në ujërat e brendshme të RSH.

“...Në vijim të konsolidimit të mëtejshëm të forcave reaguese për operacionet e Emergjencave Civile dhe SAR, jemi në përfundim të projektit

për ristrukturimin, përgatitjen dhe modernizimin e mëtejshëm të forcave të deklaruara për misione SAR. Në këtë projekt për të shkurtuar kohën e reagimit, kemi parashikuar shpërndarjen gjeografike të tyre dhe për t’iu gjendur sa më pranë njerëzve në nevojë si dhe ngritjen e një qendre specifike për trajnimin e kualifikimin e personelin për reagim në operacionet e EC dhe SAR. Në këtë kontekst, FARSH, me mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe qeverisë, ka përmirësuar trajtimin fi-

nanciar, ka rritur ndjeshëm kapacitetet reaguese për operacionet SAR, dhe do vijojë në realizimin e projekteve të modernizimit për personelin që operon në tokë, ajër apo det, etj...”, - theksoi gjeneralmajor Arben Kingji.

Në mbyllje të përshëndetjes së tij, SHSH-PFA inkurajoi përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse të vijojnë të stërvitin, trajnojnë e kualifikojnë personelin e tyre, të përmirësojnë koordinimin ndërinstitucional si dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje, dhe i siguroi ata për mbështetjen e SHPFA për përkujdesjen e kualifikimin ndaj personelit që shërben në strukturat SAR, kompletimin e strukturave me mjete dhe pajisje moderne, me qëllim realizimin me sukses të misionit SAR në RSH.

Pjesëmarrësit në ceremoni ndoqën një demonstrim nga aktorët e përfshirë në këtë stërvitje ndërinstitucionale, me qëllim testimin, vlerësimin, koordinimin dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet shtetërore dhe joshtetërore në operacione SAR.



Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu e cilësoi projektbuxhetin për vitin 2025, një buxhet historik që shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe të sigurisë kombëtare. Gjatë fjalës së tij në seancën parlamentare dedikuar projektbuxhetit të vitit 2025, ministri Vengu tha se për vitin 2025, buxheti i sektorit të Mbrojtjes parashikon një total prej 52,7 miliardë lekësh, që përbën një rritje prej 4,6% krahasuar me vitin 2024.

Teksa kërkoi mbështetjen për miratimin e këtij projektbuxheti, ministri i Mbrojtjes u shpreh se, shpenzimet e Mbrojtjes rriten nga 215\$ për frymë, në 219\$ për frymë në vitin 2025.

“Për vitin e dytë radhazi, Buxheti i Mbrojtjes mbetet mbi kufirin 2% të PBB, ndërkohë që mbi 20% e totalit të shpenzimeve i dedikohen investimeve në pajisje kritike dhe modernizim”, - u shpreh ministri Vengu. Sipas tij, për vitin që vjen totali i shpenzimeve kapitale vjen në rritje: “Kemi një vlerë prej 28,2 miliardë lekësh, ku shpenzimet kapitale me financim të huaj janë në masën 12,2 miliardë lekësh”, - tha ministri i Mbrojtjes.

“Hapësira fiskale, - shtoi ministri i Mbrojtjes, - na lejon që të konsiderojmë nga viti 2025 edhe mundësinë e kredisë së huaj nga vendet partnere dhe përkatësisht nga partneri ynë strategjik për të financuar projektet e modernizimit të forcave të armatosura”.

Një nga prioritetet kryesore të këtij buxheti është rritja e pagave për personelin ushtarak: “Është parashikuar një rritje domethënëse mbi pagë, nga e cila përfitojnë rreth 6 mijë ushtarake, ku rishtas përfitojnë rreth 2500 prej tyre. Rritja e vijueshme e pagave e çon në fakt në 71% rritjen që nga viti 2021. Pra përpjekja e madhe buxhetore që i kërkojmë taksapaguesit shqiptar i dedikohet pikë së pari trajtimit dinjitoz të personelit ushtarak. Ky është vetëm një ilustrim sesi rritja ekonomike e vendit rishpërndahet në familjet shqiptare”, - theksoi ministri Vengu.

Ky është një hap domethënës drejt arritjes së objektivit të qeverisë shqiptare për një trupë ushtarake të mirëpajisur, të mirëpaguar dhe të mirëstërvitur, nënvizoi më tej, ministri i Mbrojtjes. Nga ana tjetër, sqaroi ministri në fjalën e tij, projektbuxheti siguron rreth 1

Projektbuxheti historik i 2025, në siguri dhe forcim të kapaciteteve mbrojtëse



miliard lek, për strukturën rezerviste përgjatë vitit 2025, si një komponent i rëndësishëm, për t'iu përgjigjur në kohë nevojave dhe ndryshimeve të sigurisë rajonale dhe më gjerë. Synimi është që deri në vitin 2030 ky komponent të përbëjë rreth 1/5 e Forcave të Armatosura ose në shifra 2100 forca.

Modernizimi dhe rritja e gatishmërisë operacionale, zë vendin më të madh të burimeve financiare me një peshë specifike prej 54,8% e Buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin

2025. Ky buxhet siguron vijimësinë e 21 projekteve të modernizimit, që janë në zbatim e sipër dhe fillimin e 8 projekteve të reja në sisteme mbrojtëse për rritjen e reagimit të shpejtë të Forcave të Armatosura.

Një vëmendje kryesore në këtë projektbuxhet është edhe pjesa e emergjencave civile që në këtë buxhet, sipas ministrit Vengu janë në vlerën 5,5 miliardë lekë, duke njohur rritjen më të konsiderueshme të viteve të fundit.

Ringritja e Industrisë Ushtarake në vendin

tonë, një proces tashmë i nisur, i cili do të kthejë aftësitë zhvilluese dhe prodhuese, të municioneve, lëndëve plasëse dhe armatimit të lehtë, mbështetur në teknologjinë më të avancuar për prodhimin e tyre, për ta kthyer këtë industri në nivele konkurruese edhe për tregjet ndërkombëtare, është një tjetër pikë e këtij buxheti. Sipas Ministrisë Vengu, rivitalizimi i Industrisë Ushtarake, do të sjellë gjenerimin e të ardhurave brenda vitit 2025.

AFA organizoi konferencën “Ripërtëritja e Historisë”

Me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, Akademia e Forcave të Armatosura në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave organizoi Konferencën “Ripërtëritja e Historisë”. Në këtë konferencë të pranishëm ishin zv/ministri i Mbrojtjes Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, Ambasadori i Republikës së Kosovës, z. Skënder Durmishi si dhe akademikë profesorë, historianë të fushës së historisë.

Qëllimi i kësaj konference është krijimi i një forumi të hapur për komunitetin e kërkimit shkencor dhe akademik, për të reflektuar rëndësinë dhe ndikimin e çlirimit në shoqërinë shqiptare.

Synimi i saj është të realizojë rishikimin e historisë të periudhës së pasçlirimit duke integruar perspektivën e re dhe hulumtimin shkencor në interpretimin e ngjarjeve dhe proceseve historike.

Të pranishmit referuan ngjarje historike të cilat duhet t'u përcillen brezave pa deformime, sepse vetëm kështu do t'u trashëgojmë brezave identitetin kombëtar me të cilin duhet të jemi krenarë.

Konferencën e hapi komandanti i Akademisë



së Forcave të Armatosura gjeneral brigade, Bardhyl Nuredinaj, i cili theksoi rolin e rëndësishëm që luan studimi i historisë. “Duke njohur historinë tonë, njohim veten dhe mbrojmë

identitetin kombëtar. Por që të shkruhet historia, duhet të nisë me njerëzit, vendet, ngjarjet dhe koha e zhvillimit, ndaj për këtë duhen hulumtime dhe studime me përgjegjësi të plotë”, - u shpreh

gjeneral brigade Nuredinaj.

Më pas konferenca vazhdoi punimet e saj me të ftuarit historianë, të cilët vunë theksin e tyre mbi vlerat dhe rolin e rëndësishëm të saj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Letoni.

Në ditën e parë të vizitës zyrtare, gjeneralmajor Kingji u prit në një takim zyrtar nga sekretari i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes së Letonisë, z. Aivars Puriņš, të cilit i shprehu vlerësimin për kontributin thelbësor të Letonisë në ruajtjen e sigurisë në kufirin lindor të Aleancës, si dhe mirënjohjen për mbështetjen e dhënë nga FA-të letoneze ndaj kontingjenteve tanë që kanë shërbyer në misionin e NATO-s, si pjesë e Grup-Batalionit Shumëkombësh, tashmë të transformuar në brigadë, në varësi të drejtpërdrejtë të Divizionit Shumëkombësh të Veriut.

Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit theksuan ndër të tjera nevojën e forcimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë midis dy vendeve respektive.

Më pas shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji u mirëprit me një ceremoni zyrtare nga homologu i tij, gjenerallejtënant Leonids Kalniņš. Gjeneralmajor Kingji pasi e ka falënderuar për pritjen, ka vlerësuar zhvillimin e këtij takimi, si një mundësi të shkëlqyer për të diskutuar mbi çështje bashkëpunimi në interes të përbashkët dypalësh dhe si vende anëtare në NATO.

Nga ana e tij, gjenerallejtënant Kalniņš, pasi i ka uruar mirëseardhjen, e njohu gjeneralmajor Kingjin me misionin, përbërjen dhe zhvillimet më të fundit të Forcave të Armatosura letoneze, më në veçanti me proceset e modernizimit dhe sfidat e sigurisë.

Të dy autoritetet e larta ushtarake gjatë takimit u shprehën të gatshëm për rritjen e bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve, me qëllim rritjen e ndërveprimit dhe shkëmbimit të eksperiencave.

Gjithashtu, gjeneralmajor Kingji vlerësoi kontributin e FA-ve letoneze në misionin e KFOR-it dhe për rolin pozitiv në mbështetje të procesit



integrues Euro-Atlantik të Kosovës.

Axhenda e ditës së parë të vizitës zyrtare të SHSHPFA ka vijuar edhe me takimin me

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në Letoni



drejtorin e Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Komunikimin Strategjik, me bazë në Letoni z. Jānis Sārts, i cili zhvilloi një prezantim njohës me misionin, detyrat dhe rëndësinë e Komunikimit Strategjik në strukturat e NATO-s dhe në institucionet e Sigurisë dhe të Mbrojtjes të çdo vendi anëtar, ku ndër sfidat kryesore është dezinformimi nxitur nga influenca malinje të palëve të treta për të rritur tensionet dhe pakënaqësitë në opinionin publik.

Në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Letoni, axhenda e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji vijoi me vizitën në Divizionin Shumëkombësh të Veriut (MND-D) në Camp Adazi, ku u prit nga komandantja e këtij Divizioni, gjeneralmajor Jette Albinus.

Me anë të një prezantimi njohës të misionit, detyrave dhe strukturës së kësaj njësie të rëndësishme të NATO-s, gjeneralmajor Albinus ndër të tjera vlerësoi kontributin e Shqipërisë dhe të Forcave të Armatosura që në vitin 2017, duke nxjerrë në pah profesionalizmin dhe përkushtimin e secilit në realizimin e misionit dhe detyrave.

Gjeneralmajor Kingji gjatë takimit, pasi e falënderoi gjeneralmajor Albinus për pritjen, vlerësoi rolin e lidhshëm si komandante e Divizionit si dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj kontingjentit tonë që shërben në këtë mision.

Më tej vizita vijoi me takimin me drejtuesit e Brigadës dhe Grup-Batalionit Shumëkombësh. Gjatë takimit dhe bisedës me kontingjentin

shqiptar, togës EOD, gjeneralmajor Kingji shprehu mirënjohje dhe falënderim për profesionalizmin dhe sakrificën e secilit prej tyre duke përmendur në veçanti vlerësimet më të mira të marra nga eprorët e strukturave në të cilën shërbejnë.

Gjithashtu SHSHPFA, gjatë takimit me efektvët e kontingjentit shqiptar që shërben në

misionin e NATO-s në Letoni, vuri theksin në rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë nisur nga vetë specifika e detyrës së tyre, si dhe i garantoi ata se do të kenë gjithnjë mbështetjen e Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes për kryerjen me sukses të misionit.

Vizita e SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji u përmbyll me kryerjen e homazheve në memorialin e dy Dëshmorëve të Atdheut, nëntetar Zarife Hasanaj dhe major Klodian Tanushi, që ranë në krye të detyrës, më 6 maj 2019. Që në muajin korrik 2024, Grup-Batalioni Shumëkombësh (në varësi të Brigadës Shumëkombëshe të Këmbësorisë së Mekanizuar Letoneze) kaloi në varësi të Brigadës Shumëkombëshe të NATO-s (me strukturë eprore Divizionin). Shtabi i Divizionit Shumëkombësh në Veri është plotësisht i aftë të planifikojë dhe komandojë operacionet ushtarake, forcat e caktuara, të organizojë dhe të kryejë stërvitje ushtarake, të ekzekutojë detyra të lëshuara nga autoritetet ushtarake kombëtare dhe aleate, dhe në këtë mënyrë kontribuon në rritjen e ndërveprimit midis forcave të vendeve pjesëmarrëse dhe aftësinë e tyre për të kryer operacione të mbrojtjes kolektive sipas Traktatit të Uashingtonit.



Përfundoi stërvitja e Forcës Detare “Flotex 2024”

Stërvitja Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, e cila shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Distrikteve Detare dhe Flotiljeve Detare në bashkëpunimin me Qendrën e Zhytjeve dhe Shërbimin Hidrografik për realizimin e misionit dhe detyrat e tij themelore.

Gjithashtu nga anijet e Flotiljeve të Distriktit Detar Verior dhe Distriktit Detar Jugor u zhvilluan qitjet detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është përmirësimi i bashkëpunimit midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, Qendrën e Zhytjeve e Shërbimin Hidrografik si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR). Forca Detare do të vazhdojë të kontribuojë me kapacitetet e saj në interes të rritjes së sigurisë detare në detin Adriatik dhe Jon si dhe detin Mesdhe si pjesë e angazhimeve të saj në kuadër të NATO-s.





U zhvillua ceremonia e fillimit të stërvitjes familjarizuese mjekësore midis ROL -1 BKL dhe ROL -1 të regjimentit mjekësor të FSK-së

U zhvillua ceremonia e fillimit të stërvitjes familjarizuese mjekësore midis ROL-1 BKL/GBKL dhe ROL-1 të Regjimentit Mjekësor të FSK-së. Në ceremoninë e rastit merrnin pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, atashëu ushtarak i Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti, shefi i Shtabit i Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, komandanti i BKL/GBKL, kolonel Xhevahir Kërkhalliu, si dhe shefa nga shtabi i FT-së dhe BKL/GBKL.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është familjarizimi i personelit mjekësor i të dy qendrave shëndetësore Rol-1 BKL/GBKL dhe ROL-1 të regjimentit mjekësor të FSK-së, standardizimi i procedurave standarde të veprimit, si dhe protokollet e mjekimit për të dëmtuarit në fushën e luftimit.

Stërvitja synon në rritjen e aftësive të personelit mjekësor, në dhënien e ndihmës së parë mjekësore, evakuimin e pacientëve nga vendi i dëmtimit në pikën e grumbullimit të të dëmtuarve, transportimi e tyre në qendrën shëndetësore fushore Rol-1, triazhimi, stabilizimi dhe transferimi në qendrat shëndetësore Rol-2 ose Rol-3, në vartësi të gravitetit të dëmtimit. Gjatë stërvitjes mjekësore do të improvizohet dhënia e ndihmës së parë për të dëmtuarit me kontaminime bio-kimike.

Krahas testimit të aftësive profesionale, personeli mjekësor do të trajnohet edhe për mënyrat e plotësimit të dokumentacionit si: nëntë linjat e evakuimit mjekësor, kartela shoqëruese e të dëmtuarit nga vendi i dëmtimit në qendrën shëndetësore Rol-1, kartela mjekësore e mbajtur gjatë kohës së stabilizimit, si dhe kartela shoqëruese për në nivelet më të larta mjekësore Rol-2 dhe Rol-3.

Gjatë zhvillimit të kësaj stërvitjeje, krahas situatave të improvizuara sipas skenarëve të stërvitjes, në të dy qendrat shëndetësore do të kryhen vizita mjekësore reale për ushtarakët që kanë probleme shëndetësore, si dhe për popullsinë civile të zonës.

Përfundoi me sukses stërvitja “Multinational Readiness Exercise (MNRE)” në Persano, Itali

Në zbatim të plan kalendarit të stërvitjeve të Forcës Tokësore për vitin 2024, një togë e Regjimentit të Këmbëtorisë së Jugut (RKJ) mori pjesë në stërvitjen “Multinational Readiness Exercise (MNRE)”, e cila u zhvillua në Persano, Itali.

Kjo stërvitje ishte pjesë e serisë së stërvitjeve të Grup - batalioni të Bashkimit Evropian, në të cilën morën pjesë personel nga brigada “Garibaldi” e Forcave të Armatosura italiane si dhe personel nga Forcat e Armatosura hungareze.

Stërvitja kishte si qëllim rritjen e integritetit, ndërveprueshmërisë dhe kohezionit të forcave në nivel stafi dhe njësisë, me synim sigurimin e kapaciteteve të kombinuara për një dislokim efektiv sipas detyrave të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Në këtë stërvitje efektivat e Regjimentit të Këmbëtorisë së Jugut kryen një sërë detyrash sipas skenarëve të stërvitjes si: shoqërim konvoji, menaxhim refugjatësh, pika kontrolli, operacione sigurie bllokim dhe kundërsulm.

Personeli i togës së Regjimentit të Këmbëtorisë së Jugut përfaqësoi denjësisht FARSH në këtë stërvitje, duke marrë vlerësime tepër pozitive nga autoritetet drejtuese.



Efektivët e Kontingjentit XV EOD përfunduan detyrën në mbështetje të stërvitjes “Resolute Warrior-2024”

Efektivët e Kontingjentit XV, të cilët i janë atashuar brigadës shumëkombëshe të Prezencës së Përpunuar të Përforuar, në Letoni, përfunduan detyrën në mbështetje të stërvitjes “Resolute Warrior”.

Gjatë kësaj stërvitjeje, toga EOD ka realizuar mbështetjen me operacione EOD për të gjitha njësitë e brigadës shumëkombëshe, duke bërë asgjësimin e municioneve të paplasura të kalibrave të ndryshëm.

Realizimi me sukses i detyrave të rëndësishme në kuadër të misionëve ndërkombëtare, i radhit efektivët tanë krah aleatëve të tjerë të NATO-s.

Në ceremoninë e ditës së Vizitorëve të Shquar në kuadër të stërvitjes “Resolute Warrior”, në të cilën morën pjesë personalitete të larta, ndër to Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, Republika e Shqipërisë u përfaqësua nga ambasadori i saj në NATO, zoti Ilir Gjoni.

Zoti Gjoni, realizoi takim me efektivët e Kontingjentit XV, ku shprehu falënderime dhe mirënjohje për kontributin e tyre në operacione ushtarake të NATO-s.

Gjithashtu zoti Gjoni kreu homazhe në nder të dy Dëshmorëve të Atdheut, të rënë në krye të detyrës në Camp Adazi, Letoni.



Përfundoi stërvitja e përbashkët “Shpëtimi 2024”

Efektivët e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile realizuan stërvitjen e përbashkët për operacionet e kërkim-shpëtimit, me efektivë të strukturave të kërkim-shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo stërvitje e përbashkët u zhvillua për një periudhë njëjavore në ambientet e Qendrës Ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit në Pomozatinë, Kosovë.

Testimi i kapaciteteve operacionale të ekipeve të kërkim-shpëtimit, shkëmbimi i eksperiencave në lidhje me të gjitha veprimet të cilat kryhen në rast të fatkeqësive natyrore dhe njerëzore, testimi i njohurive teorike dhe praktike të përfituara gjatë trajnimeve të ndryshme, ishin objekt i kësaj stërvitjeje. Realizimi i stërvitjeve të përbashkëta, kurseve, trajnimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive reaguese në mbështetje të operacioneve të emergjencave civile, janë ndër prioritetet e Komandës Mbështetëse, e cila synon që në çdo kohë të rrisë ndërveprueshmërinë me efektivë të strukturave të tjera të Forcave të Armatosura dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.



22 nëntor 1989... Helikopteri MI-4 koduar me shifrën “650” ishte ngritur në ajër me urgjencë pas alarmit se diku në Qafën e Llogorasë, një autobus me studentë kishte përfunduar në humnerë. Dy pilotët dhe tekniku, së bashku me një ekip mjekësh e ndihmësmjekësh, të gatshëm për të kryer një mision humanitar në shpëtim të jetëve të tyre, u nisën rrëmbimthi nga pista e regjimentit të Farkës edhe pse parametrat e kohës nuk tregonin asgjë optimale.

E ndërsa bazamenti prej betoni zvogëlohej rrufeshëm, secili prej tyre mendonte se vetëm disa orë më vonë, kur gjithçka do të përfundonte, helikopteri me flatrat e mëdha do të ulej përsëri aty, dhe ata do të mund të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre me gjysmën e shpirtit të lehtësuar, se në fund të fundit kishin shpëtuar disa jetë njerëzore. Koha ishte e keqe, binte shi dhe vetëtimat shkarkonin masa elektrike në ajër.

Sinan Çela, Komandanti i Regjimentit, udhëhiqte operacionin nga kulla e komandimit deri në çastin kur lidhja u shkëput. Pas kësaj heshtja ishte e plotë. Duhet të ketë qenë ora 17:55 minuta, kur helikopteri i parë ra në shpatin e Karaburunit. Vetëm gjashtë apo shtatë minuta më pas, diku në Vuno, helikopteri i dytë do të rrëzohej gjithashtu tragjikisht. Në regjimentin 4040 dhe në gjithë zonën e Farkës lajmi do të përhapej me shpejtësi.

...Automjeti ka marrë tatëpjetën dhe shoferi nuk e ka pasur më nën kontroll. Autobusi rrëshqiti në humnerë në një lartësi prej gati 70 metrash. Shoferi i autobusit Ali Omuri dhe një student, Albert Smoka, humbën jetën në vend, ndërsa shumë të tjerë morën plagë të rënda mes tyre dhe pedagogu Misto Shumeli.

Për t’u ardhur në ndihmë të dëmtuarve rëndë, nga Tirana u dërguan dy helikopterë: MI-4 644 i drejtuar nga komandanti Vangjel Postoli, piloti Tafil Agaj dhe teknik Pandeli Xhumba, dhe MI-4 650 i drejtuar nga komandanti Agron Galanxhi, piloti Veledin Resuli dhe teknik Enver Haka. Në bordin e tyre kishin edhe ekipin e mjekëve të spitalit nr. 2 në Tiranë, të përbërë nga Agim Qarri, Kujtim Hysi, Dionis Makuçi, Zana Floqi si dhe ndihmësmjekja Dhurata Leka. Helikopterët u nisën drejt Llogorasë dhe pas 50 minutave fluturim u ulën në fushën e Himarës për të marrë studentët e plagosur dhe për t’i sjellë në Tiranë. Në Farkë prisnin katër ambulanca për të marrë të plagosurit. Në kthim, në një prej helikopterëve hipën mjeku Nafail Metollari dhe ndihmësmjeku Piro Kuko të spitalit të Himarës. Por tragjedia u thellua edhe më tej. Për shkak të motit shumë të keq, dy helikopterët u përplasën me shpatet e maleve, ndërsa pilotët mjekët, pedagogët e studentët, humbën jetën para se të mbërrinin në spital. Ekuipazhet e përbëra nga: Vangjel Pistoli, Agron Galanxhi, Tafil Agai, Veledin Resuli, Pandeli Zhupa dhe Enver Haka, e bashkë me ta edhe mjekët e infermierët që ishin nisur nga Tirana për të shpëtuar jetën e studentëve, nuk u kthyen më. Por në bordet e dy helikopterëve ishin gjithashtu 9 studentë e dy pedagogë Misto Shumeli dhe Thoma Plasa. Ushtarakët e Regjimentit të Farkës që ranë në këtë aksident ajror u shpallën “Dëshmorë të Atdheut” dhe prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.



Atdheu përjetë mirënjohës, yjeve të pashuar të qiellit Shqiptar



VIKTIMAT E HELIKOPTERIT TË PARË

- 1-Vangjel Postoli, komandant
- 2-Tafil Agaj, pilot
- 3-Pandeli Xhumba, mekanik
- 4-Misto Shumeli, i plagosur në aksident
- 5-Elida Hyseni, e plagosur në aksident
- 6-Donika Ferra, e plagosur në aksident
- 7-Zef Sula, i plagosur në aksident
- 8-Kujtim Hysi, mjek
- 9-Zana Floqi, mjeke
- 10-Dhurata Leka, ndihmësmjeke
- 11-Nafail Metollari, mjek në Himarë
- 12-Piro Kuko, ndihmësmjek në Himarë

VIKTIMAT E HELIKOPTERIT TË DYTË

- 1-Agron Galanxhi, komandant
- 2-Veledin Resuli, pilot
- 3-Enver Haka, mekanik
- 4-Thoma Plasa, i plagosur
- 5-Ilirjana Brahimi, e plagosur
- 6-Taip Llaçi, i plagosur
- 7-Xhelal Ndreu, i plagosur
- 8-Agim Qarri, mjek
- 9-Dionis Makoçi, mjek

ARMA E KIMISË, shërbimi elitare i FA-së

Shërbimi Kimik i Ushtrisë gjatë gjithë kohës ka qenë shërbim elitë që përgjigjej para këshillit të Mbrojtjes për vetë natyrën dhe rëndësinë e veçantë të detyrave që ai zgjidhte për Mbrojtjen e Forcave të Armatosura të popullit e të ekonomisë. Periudha 70-vjeçare e këtij shërbimi ka qenë një periudhë e gjatë pune vetëmohuese e përkushtimi nga qindra kuadro e mijëra ushtarë që kanë shërbyer në këtë armë, që me punën dhe sakrificat e tyre e çuan këtë shërbim në nivelet më të larta të mundshme; shërbim sa i vështirë aq dhe i nevojshëm, si për kohë lufte dhe për kohë paqeje, shërbim human që mbron dhe shpëton jetë njerëzish në çdo situatë. Kjo ka qenë dhe do të mbetet përherë detyra e mbrojtjes kundërkimike.

Nënreparti i parë i shërbimit të Mbrojtjes Kundërkimike, u krijua më 23 nëntor të vitit 1953. Komandanti i Nënrepartit të parë të Shërbimit Kimik (kështu quhej struktura e parë e krijuar) u emërua Shyqyri Kondi. Po në këtë kohë me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes u krijua edhe Dega e Mbrojtjes Kundërkimike pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Kuadrot e parë ishin ata të dalë nga lufta antifashiste dhe të përgatitur me kurse dhe kryesisht në shkollat ushtarake të ish-Bashkimit Sovjetik dhe më vonë në Akademinë tonë të Mbrojtjes, si Shyqyri Kondi, Kristaq Haxhimiali, Thodhori Gjoni, Hamit Murga, Uran Puto, Abdyl Dobi, Esat Xhepa Guri Shyti, Lame Prifti, Qëndro Laba, Enver Lagji, Hysen Murtati, Sami Meçollari, Hysen Kola, Kristaq Mici, Pirro Begvarfi, Zija Liçi, Servet Muka e shumë e shumë të tjerë që dolën më vonë nga Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve.

Në vitin 1954 pranë Shkollës së Bashkuar të oficerëve u hap edhe Kursi i Kimisë, që filloi të përgatiste kuadrot e para të vendit, të cilët me ndjenjë të lartë dhe përkushtim rritën nivelin teknik dhe gatishmërinë luftarake të reparteve dhe njësisë të Ushtrisë.

Gradualisht, me rritjen e modernizimit të ushtrisë u shtua dhe u modernizua edhe shërbimi kimik, që ndonjëherë edhe e quanim Arma e Kimisë, dhe kjo për përmasat dhe rëndësinë që mori. Kështu në vitin 1961, kompania e kimisë u kompletua me teknikën e armatimit kimik, me teknikë zbulimi dhe përpunimi. Rëndësi e veçantë fillimisht, i kushtohesh përvetësimit të teknikës dhe kompletimit të ushtrisë me mjetet e mbrojtjes kundërkimike.

Në vitin 1964, pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm u hap dega e Mbrojtjes Kundërkimike, me shef katedre N/kolonel Kristaq Haxhimihalin, prej ku filluan të dalin kuadrot e lartë ushtarak.

Në vitin 1967, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes u krijuan tre batalione, dy të mbrojtjes kundërkimike, njëri në Tiranë me komandant Koço Stojkun dhe tjetri në Berat me komandant Refat Shehatin, kurse batalioni i tretë ishte ai flakëdhës në Tiranë me komandant Ahmet Mehmetin, që të tre Rezervë të Shtabit të Përgjithshëm.

Po në këtë kohë pranë shtabeve të divizioneve u krijuan kompanitë e mbrojtjes kundërkimike dhe ato flakëdhëse, të cilat me kalimin e Ushtrisë në sistemin me Korpuse, kaluan në batalione kimie dhe flakëdhëse, të kompletuara me teknikë dhe armatim të plotë kimik. Po kështu, pranë korpuseve u krijuan edhe laboratorët e kimisë të korpuseve me shefa laboratorësh inxhinierë kimistë, që kishin në vartësi edhe oficinat e riparimit të teknikës dhe armatimit kimik të korpusit dhe, që kanë bërë një punë të lavdërueshme për rritjen cilësore teknike të këtij shërbimi.

Më 1969, pranë reparteve të kimisë në Brar, u krijua Shkolla e Përgatitjes së Kuadrove Oficer Rezervist, me komandant Muharrem Durmishin.

Zhvillimi i vullshëm i shërbimit kimik bëri që edhe drejtimi të kalonte nga degë në Drejtori të Mbrojtjes kundërkimike. Në këtë kohë, kur drejtues të saj ishin Enver Lagji dhe Muharrem Durmishi, u bë një punë shumë e madhe në drejtim të studimit dhe prodhimit në vend të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike dhe të likuidimit të pasojave të ndotjeve. Është, pikërisht, kjo kohë kur u krijuan shumë grupe pune studimore me specialistët më të mirë, të cilët e kurorëzuan me sukses krijimin e uzinës së kimisë, që prodhoi kundërgazin shqiptar me parametra të matshëm me bashkëkohorët, u prodhuan paketa individuale kundërkimike, kompletet e degazimit e përpunimit, kostumet mbrojtëse e kompleti mbrojtës Nr.1 e shumë të tjera.

Pranë ambienteve të kompanisë së kimisë, më 1 gusht 1965, u hap Laboratori Qendror i kimisë në FA, me kimistin e talentuar



Kudret Meta dhe dy laborantë. Hapja e këtij Laboratori kishte si qëllim përgatitjen teknike të kuadrove të mesëm dhe të lartë të kimisë, kryesisht si një bërthamë studimore për aplikimin në ushtri të të rejave shkencore lidhur me ADM (Armët e Dëmtimit në Masë) dhe mbrojtjen prej tyre, sidomos në drejtim të armës së kimisë dhe mjeteve djegëse, për t'iu përgjigjur situatave të mundshme kimike, që mund të krijoheshin, duke e përqendruar vëmendjen fillestare në këto probleme: gjetja dhe aplikimi i metodave të analizave të lëndëve helmuese luftarake; kryerja e analizave të lëndëve që ndotëse, që mbahen në ruajtje; aplikimi i metodikave për përgatitjen dhe përdorimin e mjeteve që ndotëse; studimi i aftësisë mbrojtëse të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike; përgatitja e përzierjeve djegëse për flakëdhësit.

Jo vetëm kaq, por prodhoi dhe furnizoi edhe industrinë me gypa indikator për gazrat e dëmshëm industrialë, hoqi nga importi shumë kimikate dhe lëndë të tjera të domosdoshme për prodhimin e këtyre gypave.

Që nga viti 2007, me mbështetjen e qeverisë Amerikane dhe nën monitorimin e plotë të OPCW (Organizata për ndalimin e armëve kimike) u bë asgjësimi i plotë i të gjithë sasisë së LHL (Agjent kimik) që ka disponuar Shqipëria.

LHL (Agjentët kimikë) + Mjetet e përdorimit = Arma kimisë Ushtria jonë ka patur në dispozicion vetëm një nga dy komponentët që përbëjnë armën e kimisë LHL dhe nuk ka disponuar asnjëherë mjete të përdorimit të tyre.

Shqipëria, deri në vitin 2007, ka trashëguar nga sistemi i kaluar komunist rreth 16 ton iprit mësimor, sasi të vogla të klorpikrinës – LHL ngacmuese – asfiktike, që është përdorur vetëm në Luftën e Parë Botërore për qëllime luftarake. Po ashtu, kemi patur sasi të vogla (jo me ton dhe kuintal, por me kg- iprit luftarak, luizit dhe sarin, që janë përdorur për studime shkencore. Vonë janë sjellë sasi të vogla kloracetofeni.

Laboratori Kimik, në vitin 1969, arriti që me këmbëngulje të sintetizonte (prodhonte) pothuajse të gjitha llojet e LHL që njiheshin përfshi sarinë në sasi shumë të vogla dhe kjo është bërë për të patur mundësi të studioheshin e prodhoheshin mjetet e zbulimit të tyre kimik të mbrojtjes prej tyre dhe të mos ndotjes së tyre.

Laboratori prodhoi të gjithë gypat indikator të lëndëve helmuese. Sasitë e saj kanë qenë tepër të vogla dhe nuk është përdorur asnjëherë për qëllime luftarake, manovra apo stërvitje.

Kur përmendet kjo armë, në kujtesë të vjen menjëherë kundërgazi. Te ne, fillimisht erdhën modele sovjetikë dhe kinezë, por më

pas u arrit të prodhohet në vend nga Ndërmarrja e Prodhimeve Kimike të Ushtrisë në Tiranë. Kundërgazi eksperimental u prodhuan në vitin 1971, ndërsa në vitet 80-të, kur punohej me ritëm të plotë për të kompletuar të gjitha nevojat e ushtrisë, sasia vjetore arriti në 100000 komplete në vit.

Maska dhe gypi i kundërgazit prodhoheshin nga Ndërmarrja Gomë-Plastikë Durrës. Ndërmarrja Kimike u nda me administratë më vete dhe u quajt "Rep.Ush.1190". Aty nisën të prodhoheshin karboni aktiv dhe katalitik për mbushjen e kundërgazeve, kutitë tymuese individuale dhe të tankeve (ku ngjeshja e kallëpit me lëndën përbërëse kryhej me një presë me friksion 120 tonë, të realizuar nga Kombinati Metalurgjik Elbasan), si dhe produkte të tjera për stërvitje. Karboni aktiv dhe katalitik prodhohej nga bërstitë e farave të ullirit. Përveç kundërgazit individual, ishin dhe filtrat e mbrojtjes kolektive, të cilët montoheshin në strehime apo objekte të tjera. Përveç këtyre, ishin dhe filtrat 50 dhe 100 m3/orë. Filtrat kanë të njëjtin konstruksion si të kundërgazit individual, pra një element filtrues prej letre të valëzuar dhe një element filtrues prej karboni katalitik. Parafiltiri, siç e thotë dhe emri, është i përbërë vetëm nga element filtrues prej letre me strukturë speciale. Për këto filtra u kryen studime për t'i prodhuar në vend dhe u arrit deri te prodhimi eksperimental i prototipave. Tepër i vështirë ishte realizimi në rrugë industriale i letrës së valëzuar (si fizarmonikë). Te parafiltiri, kishte përmasat e një fizarmonike të vogël. Problem i kushtueshëm ishte dhe mbyllja e kapakut në po atë mënyrë siç mbyllen dhe kutitë e konservave. Te kundërgazi individual, këto probleme ishin zgjidhur, sepse kishte përmasa të vogla.

Gati një industri e tërë e realizuar me mjeshtëri nga ushtarakët tanë.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Dëshmorët klerikë bektashinj, rënë për Atdhe dhe fe

Baba Meleq Shëmbërdhenji, personalitet i shquar i Rilindjes Kombëtare. Për fillimin e punës së tij si klerik dëshmon gazeta “Liria” e Selanikut, e 16 tetorit 1910, e cila shkruan: “Mësuam se të palodhurin mëmëdhetar varfe Meleqin e paskan zgjedhur atë, baba në teqenë e Shëmbërdhenjit”. Në vitin 1902 e arrestojnë në Krujë dhe e burgosin. Arratiset nga burgu, por punën për gjuhën shqipe nuk e ndalon. Ishte një ndërlidhës i shkëlqyer midis atdhetarëve të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut. Vetëm në vitet 1904-1905 shpërndau rreth 2.000 libra dhe abetare shqip nga Frashëri deri në fshatrat e Krujës. Gëzonte respektin e atdhetarëve brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ka qenë delegat në Kongresin e Manastirit në vitin 1908 dhe ka dhënë kontribut të veçantë për punën dhe idetë e këtij kongresi. Mori pjesë në gëzimin e ditës së Flamurit më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Mbështeti fort qeverinë e Ismail Qemalit.

Baba Meleqi ka qenë edhe një dijetar e vjershëtar i spikatur. Vjershat e tij dallohen për frymën e shprehur kombëtare. Ato nxisin zgjimin e ndjenjës së besimit, të mirëqenies, drejtësisë dhe mirësisë. Për Baba Meleqin, atdheu dhe perëndia ishin një. Për veprën atdhetare në shërbim të kombit, Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar Baba Meleqin (pas vdekjes) me urdhrin “Për shërbime patriotike”, si dhe me titullin “Mësues i Merituar”. Pas vdekjes, më 25 shkurt 1927, Baba Meleqi u varros në tyrbën e Baba Mustafait, ku qëndroi deri në fund të viteve '60. Më pas u vendos në varrezat e dëshmorëve në Skrapar për t'u kthyer përsëri në “shtëpinë e tij”, në Teqenë e Shëmbërdhenjit, pas viteve '90. Është shkruar në FESH.

Në vargun e dëshmorëve të Atdheut nga klerikët bektashinj, vendin e nderit e zë kryegjyshi Sali Njazi Dede, i cili qëndroi stoik si mali i Tomorit dhe nuk pranoi presionet nga qarqet profashiste për të aprovuar dhe firmosur pushtimin e vendit nga Italia fashiste. Ai nuk u nënshtroi dhe, më 28 nëntor 1941, ai ra dëshmor, duke dëshmuar traditën e bektashizmit, e cila është përmbledhur në idenë “pa atdhe, nuk ka fe”. Ai bëri të mundur sjelljen e Qendrës Botërore të Bektashinjve në Shqipëri, duke mbetur në përjetësi krenaria e të gjithë shqiptarëve, modeli me dije të mëdha të një kleriku, shfaqti tolerancë dhe urtësi, u shfaq reformatori i parë i besimit bektashi, duke e ngritur atë në nivele të larta përfaqësimi në botë. Ai kishte ndjenjën e lartë të atdhedashurisë dhe e ngriti bektashizmin në Shqipëri në një përmasë të re historike, duke pasuruar traditën bektashiane që vazhdon dhe sot. Me këtë qëndrim vërtetoi thënien e Haxhi Bektash Velit, se me fikjen e dritës nga Lindja, ajo ka për t'u ndezur në Perëndim. Sali Njazi Dede është shpallur dëshmor i Atdheut nga Bashkia e Tiranës me vendim nr. 505, datë 20.12. 2011, është dekoruar nga presidenti i Republikës me titullin “Nderi i Kombit” dhe nga Posta Shqiptare është vendosur në pulla portreti i tij, si figurë e shquar e kombit. Emri i tij ka zënë vend të dukshëm dhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, të botuar në vitin 2008, nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Një vend nderi zënë klerikët e Teqesë së Rabies, të cilët qëndruan në këmbë dhe ndihmuan pa u kursyer luftën, e kthyen teqenë në çerdhe të lëvizjes, vunë tërë kapitalin e tyre për partizanët dhe lëvizjen. Teqeja është dekoruar me “Medaljen e Trimërisë” në vitin 1945.

Baba Abaz Sherif Memushaj, nga Rabia. Kur atdheu e kërkoi u bë luftëtar në vitet e Luftës së Parë Botërore dhe në Luftën e Vlorës 1920. Teqeja e Rabies ishte në një pozicion strategjik, ku zotëron tri krahina: Berat, Mallakastër dhe Tepelenë. Batalioni partizan që u krijua pas masakrës, u pagëzua me emrin e klerikut të nderuar “Baba Abaz”. Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 44, datë 03.08.1971, të Komitetit Ekzekutiv Tepelenë.

Dervish Bajram Lame Lamaj nga Levani i Tepelenës. U edukua në një familje fisnike me tradita bektashiane dhe atdhetare. Teqeja e Rabisë i shtoi dashurinë për besimin e mrekullueshëm. U vesh dervish në teqenë e Prishtës dhe më pas kaloi në teqenë e Rabies që e kishte për zemër. Kleriku më i ri para pushkatimit, më 23 korrik 1943, thirri “Rroftë Shqipëria”. Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 151, datë 27.12.1979 të Komitetit Ekzekutiv Tepelenë.

Dervish Feim Haxhi Mahmutaj nga prindërit u edukua me dashuri për besimin bektashian, por dhe për veprimtarinë fetare dhe patriotike të baballarëve dhe dervishëve në teqetë e vendit. Në vitin 1941 ishte dervish në teqenë e Rabies dhe baba Abazi e orientoi që të përkrahte Luftën Nacionalçlirimtare. Në vitin 1942 u në anëtar i çetës territoriale të fshatit Gllavë. Masakrohet më 23 korrikut 1943, në teqenë Rabies dhe është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 44, datë 03.08.1971 të Komitetit Ekzekutiv Tepelenë.

Dervish Bardho Rustem Bardhi u lind në Gusmar të Tepelenës, në një familje me tradita bektashiane. Prindërit i dhanë edukatë

Martirë bektashinj në kujtesën e popullit shqiptar

Baba
Meleq ShëmbërdhenjiKryegjysh
Sali Njazi DedeDervish
Feim Haxhi MahmutajDervish
Bardho Rustem BardhiBaba
Abaz Sherif MemushajDervish
Bajram Lame LamajBaba
Faja MartaneshiBaba
Fejzo Shaban Dervishi

dhe dashuri për besimin bektashian. U dallua si aktivisti i Lëvizjes Antifashiste dhe ishte ndërlidhës i çetave e batalioneve në vitet 1942-1943. U masakrua në italianët në Rabie, më 23 korrik 1943. Është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 149, datë 27.12.1984, të Komitetit Ekzekutiv Tepelenë.

Në listën e dëshmorëve të Atdheut janë dhe Baba Faja Martaneshi “Hero i Popullit”. Mustafa Dalip Xhani, gjatë luftës ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Partizane, shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 161, datë 29.12.1971, të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. Figura e tij është pasqyruar në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 1985 dhe 2008. Në FESH shkruhet se u vra më 17 prill 1947, në Kryegjyshatën Bektashiane Botërore në rrethana të pasqaruara, dhe nuk theksohet që është dëshmor i Atdheut.

Dëshmor i Atdheut është dhe Baba Fejzo (Fejzo Shaban Dervishi), me vendim nr. 103, datë 31.07.1977 të Komitetit Ekzekutiv të Skraparit. Gjatë luftës ka qenë anëtar i shtabit të Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër 1943-1944. Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 1985 dhe të vitit 2008, për të dy figurat nuk shkruhet që janë shpallur dëshmorë të Atdheut.

Martirë bektashinj të rënë për Atdhe
Meritojnë vlerësim nga shteti shqiptar për kontributin e tyre të dhënë për çështjen kombëtare dhe për gjakun e sakrificat e tyre të shpallen dëshmorë të Atdheut, sipas ligjit 109/2018 dhe këta martirë të bektashizmit.

Kryegjysh Ali Riza Dede, gjatë Luftës së Dytë Botërore dha një kontribut në përkrahje të luftës për çlirimin e Atdheut, duke aktivizuar baballarë dhe dervishë në Luftën Antifashiste. Këshilli klerikal e zgjodhi baba Rizanë, Kryegjysh Botëror të Bektashinjve, më 10 janar 1942. Si Kryegjysh përfundoi godinën e madhe që ngriti Sali Niazi Dede dhe organizoi punën brenda e jashtë vendit në forcimin e bektashizmit. Vdekja e tij, më 22 shkurt 1944, në spital në Tiranë ka ngjallur që në atë kohë dyshime... dekoruar me urdhrin “Për veprimtari patriotike” të Klasit I dhe titullin “Nderi i Kombit” nga presidenti i Republikës.

Kryegjysh Kamber Ali Dede prej 12 prillit 1945, dhe u arrestua e dënua me 15 vite burg, ku ka vuajtur dhe ndërroi jetë në burgun e Tiranës, më 5 prill 1950. Dekoruar me urdhrin “Për veprimtari patriotike” të Klasit I dhe titullin “Nderi i Kombit” nga presidenti i Republikës.

Kryegjysh Abaz Hilmi Dede, u bë prijës shpirtëror në vitet 1945-1947. U kujdes që doktrina bektashiane të fitonte vizion të reja, por pa trazuar dëlirësinë e prurë prej 800 vitesh nga Haxhi Bektash Velit. Në vitin 1947 kryegjyshi iu kundërvu grupit “Përparimtar” që mori përsipër autorësinë e reformës në çështjen e martesës. Dede Abazi vlerësuar me Urdhrin “Për veprimtari patriotike” dhe titullin “Nderi i Kombit” nga presidenti i Republikës.

Baba Medin Gllava ishte në krye të çetës së luftëtarëve në vitin 1907 në përballje me armë kundër antishqiptarëve dhe pushtuesve të shumtë. Baba Medin Gllava në luftën kundër andartëve grekë plagoset dhe ndërroi jetë nga plagët e marra në luftime. Vlerësuar nga princ Vidi me “Medaljen e Artë”.

Baba Sali Matohasani, shërbente në teqenë e Golimbasit. Ismail Qemali, projektuesi i shtetit të pavarur shqiptar, kërkoi që flamurin ta bekonte patrioti i madh dhe bektashiu largpamës baba Sali

Matohasani. Vlerësuar me medaljen “Për veprimtari patriotike” në vitin 1982, me titullin “Nderi i Kombit” nga presidenti i Republikës dhe busti i tij është vendosur në Matohasanaj.

Baba Ali Turabiu (Skëndaj) u rrit në një familje me tradita bektashiane dhe ruajti këtë besim përgjithmonë. Është marrë shumë me publicistikë, ka botuar shumë libra me vlera për doktrinën bektashiane, ndaj në vitin 1945 u bë anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë. Ka pritur mjaft luftëtarë të lirisë pa bërë dallime politike. Pas çlirimit të vendit, arrestohet dhe akuzohet si bashkëpunëtor i anglo-amerikanëve. “Ruani dorëshkrimet e mia, rroftë Shqipëria” ishin fjalët e tij. Veprimtaria e tij lidhet me gjuhën, shkollën dhe kulturën kombëtare. Dekoruar me medaljen “Martir i Demokracisë” dhe me titullin “Nderi i Kombit”.

Baba Feim Vrepcka, lindur në vitin 1900, shumë shpejt u bë i njohur si baba, i ardhur nga Devolli në vitin 1927. Baba Feimi me horizont dhe kulturë, në vitin 1932-1939 e ripërtëriu teqenë që nga themelet. Ndërtoi çezmën e bukur në vitin 1932 me tre qemerë monumentale me mbishkrimin: “Pini ujë me lezet kthejeni prapë në teqetë”. Teqeja e Vrepckës 1942-1944 ishte spital për zonën e lirë operative, u ngrit dhe një central elektrik.

Më 6 qershor 1944, në teqe shkuan nazistët gjermanë. Baba Feimi për të mbrojtur teqenë dhe djemtë ai ra dëshmor. Baba Feimi ka hapur shkollë në Vrepckë dhe Zerecë. Teqeja e Vrepckës është shpallur Monument Kulture me vendim nr. 6 datë 15.1.1963.

Baba Shefqet Koshtani merr pjesë në ngritjen e Flamurit në Vlorë. Në kongresin e parë të bektashinjve ishte në mbrojtje të grupit reformator, që perspektivën e besimit e kishin të pandarë nga kombi. Priti me indinjatë pushtimin fashist dhe u lidh me patriotë e përkrahu lëvizjen. Teqeja e Koshtanit u bë bazë e luftës. Pas çlirimit u akuzua për sabotim të reformave... u pushkatua.

Baba Mustafa Canaj punoi në teqenë e Prishtës dhe zgjeroi radhët e besimit të kulluar edhe me intelektualë dhe atdhetarë të shquar. Ishte në protestë me atdhetarët e Skraparit, dënoi agresionin Italian dhe ngriti popullin në luftë. Në mjaft kuvende apo biseda të atyre kohërave, baba Mustafa Canaj, haptas mbajti krahun e nacionalistëve shqiptarë. Në majin e vitit 1945 u arrestua dhe u dënua me 101 vite burg.

Baba Qamil Gllava mori edukatë fetare, u shkollua në Berat dhe u vendos në teqenë e Gllavës. Teqeja e Gllavës u bë qendra e luftës kundër pushtuesve italianë dhe në korrik 1943 u arrestua, pse ndihmonte luftëtarët e lirisë. Ai ishte nacionalist, donte popullin dhe Atdheun, duke pritur në teqe të gjithë pa dallim ideje. U arrestua në tetor 1944, duke u akuzuar kriminel lufte dhe shkaktar të vrasjes së baba Abaz Rabies. U pushkatua në moshën 45 vjeçare.

Nga radhët e bektashinjve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare llogariten rreth 6.000 luftëtarë, kanë rënë tetë dëshmorë të Atdheut, janë vlerësuar me dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” katër kryegjysh dhe dy baba, si dhe baba është “Mësues i Merituar”, pa llogaritur vlerësimet e tjera të bërë në vite për kontributin e tyre në shërbim të Atdheut. Bektashizmi me misionin e tij “pa atdhe nuk ka fe”, në çdo kohë e ka njuar erën e barutit ende pa u shkrepuar pushka. Të rënë bektashinj në fronte të ndryshme të luftës mbeten pjesë e pandarë e lavdisë shqiptare. Asnjëherë populli ynë s’i ka veçuar këta martirë nga bijtë e tjerë, dëshmorë të Atdheut.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në përkujtim të burrave të Pavarësisë, që shkruan histori 112 vite më parë, në përkujtim të babait të kombit Ismail Qemal bej Vlora, që në rrugëtimin historik nga Stambolli evropian në Vlorë bëri 4122 kilometra, që historia e kombit tonë ta regjistronte si heroin e shqiptarëve që shpalli pavarësinë shqiptare; në nderim e respekt të 40 firmëtarëve të pavarësisë si dhe gjithë delegatëve të Kuvendit të Vlorës, por dhe qeverisë së parë të përkohshme të Vlorës, që përfaqësonte gjithë trojet shqiptare.

Me rastin e ditës së përvjetorit të shpalljes së pavarësisë, mbarë shqiptarizma është me sy e veshë nga Vlora e flamurit, ku në imazhin e shqiptarëve brenda e jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë, tek vepra e madhe e para 111 vitesh, tek shpallja e mëvetësisë. Ligjërata e plotë e Ismail Qemal bej Vlorës, të mbajtur, më 28 Nëntor 1912, në ngjarjen më madhore të kombit shqiptar, atë të ngritjes së flamurit dhe shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, ishte postulat i shekujve, për realizimin e ëndrrës së shumëpritur shekullore të shqiptarëve. Është pikërisht ligjërimi i një kombi të tërë që historia e ka gdhendur në histori madhore e së shkuarës kombëtare, dhe si detyrim i së ardhmes, fjalët e zemrës të mendjendriturit shqiptar Ismail Qemal bej Vlora, që bëri rrugëtimin historik nga Stambolli në Vlorën e tij të dashur, për të shpëtuar kombin në prag të shkërmoqjes së perandorisë osmane dhe urisë e lakmisë së fqinjëve për troje nga toka arbërore e drobitur prej vuajtjeve nga pushtimet e gjata. Ismail Qemal bej Vlora, i cili jetoj në disa shtete si në Turqi, Greqi, Itali, Bullgari, Siri, për pak kohë në Francë, Angli, Zvicër e Gjermani, erdhi në Shqipëri, si kryeministër, si kryetar i parë në historinë e shtetit shqiptar, që drejtoi nga 28 Nëntori i vitit 1912 deri në 22 janar 1914, për 12 muaj e 56 ditë. Ishte Ismail Qemali që vendosi vulën historike të burrit të madh të flamurit, të Pavarësisë së shqiptarëve, të diplomatit e shtet-formuesit që shkroi histori epokale për shqiptarët. Pavarësia shqiptare dhe epoka e rilindjes shqiptare dhe e rilindësve nuk mund të ndahen, për vetë kushtet që u poqën nga një brez i madh intelektualësh eruditë që punuan gjatë për mëvetësinë dhe krijimin e shtetit. Pavarësia udhëtoi nga Moti i Madh i Gjergj Kastriotit tek Moti i Madh i Ismail Qemalit 4 shekuj e 63 vjet. (1443-1912). Ismail Qemali me udhëtimin e tij të famshëm, plaku i bardhë i flamurit, në nëntor 1912, rrugëtoi 4122 kilometra nga Stambolli evropian në Vlorë. Ai me patriotët të tjerë përshkruan rrugën Stamboll-Konstancë-Bukuresht; nga Bukureshti në Vjenë; nga Vjena në Budapest; nga Budapesti sërish në Vjenë; nga Vjena në Trieste; nga Trieste në Durrës për t'u finalizuar në Vlorën e përjetësuar të flamurit. Pavarësia për shqiptarët ka qenë shpesh në rend të ditës, në penën e intelektualizmit shqiptar, në mendjen gjenialet të rilindjes shqiptare të frymëzuar edhe nga iluminizmi francez. Por nga ana tjetër Pavarësia ka qenë edhe në grykën e pushkës e në majën e jataganit në qindra beteja nëpër shekuj. Amaneti i gjakut të shqiptarëve udhëtoi përmes shekujsh për t'u naltuar më 1912-tën.

VULLNETI I POPULLIT SHQIPTAR FINALIZOHET 112 VITE MË PARË

Në mendjen dhe zemrat e shqiptarëve tingëllojnë edhe sot pas 112 vitesh fjalët e Ismail Qemalit, që mbajti në atë kuvend historik, në ngjarjen më të rëndësishme për shqiptarinë dhe shqiptarët, më 28 nëntor 1912, në atë kuvend që u hap në orën 16, pasdite, në shtëpinë e kushëritit të Ismail bej Qemalit, Xhemil bej Vlorës dhe ku morën pjesë 42 delegatë. Ligjërata e pavarësisë ishte: “Shqiptarët nuk e kanë harruem kurrë as gjuhën e as kombsinë e tyre, dhe prova më e mirë janë përpjekjet dhe kryengritjet që kanë bâmë herë mbas here e sidomos ndër këto katër vjet e fundit për të ruejtun të drejtat e zakonit e veta. Qeverija othomane nuk e kuptoi kurrë interesën e saj e nuk deshi kurrë t’u shpërblejë më të mirë Shqiptarët shërbimet e mëdha që i kishin bâmë. Tashti vonë pati rrëfyem nji farë deshiri që të merrej vesht me popullin t’onë. Por prap nuk vûni të gjithë vullnetin e mirë e nuk muer të gjitha masat e nevojshme për të kënaqun e paqsum Shqiptarët. Qe ndër këto rrethana qi plasi lufta me katër Pushtetet ballkanike, të cilat kërkonin prej saj reforma e të drejta për vllaznit e tyne të nji kombi e të nji bese. Por këto, si panë se lufta po u vente mbarë, e harruen qëllimin e parë e u muerën vesht për coptimin e pjestimin e mbretnisë e pra edhe të Shqipnisë. Shqiptarët, të cilët kishin marrë pjesë në këtë luftë më fort si të zott e vëndit e për të shpëtum veten e tyne se si ushtarë, kur e panë se ushtria e Tyrqisë u mund e s’po mûjte me qëndruem më, nxituen me marrë masat qi u impononte gjëndja për të shpëtum vëndin e vet. Kështu u bā që un u nisa nga Stambolli e, mbasi u mora vesht edhe me Shqiptarët e Bukureshtit, vota në Vjenë, ku fillova kontaktet me ato Pushtete të mëdha që kanë interesa më të gjalla në Ballkan. E mbasi nuk mbetej më asnji shpresë me e shpëtum Shqipninë me armë, e vetmja udhë shpëtimi ishte të shkëputnit e saj prej Tyrqije. Ky mendim u pa me vend edhe nga an’ e Pushteteve të mëdha e sidomos në Vjenë e në Romë. Vetëm Rusia mund të mbahet pakëz e ftohët nga shkaku i fqije t’anë slave, por as ajo nuk e mohon kombsinë shqiptare..” dhe që finalizohet me shprehjen e vullnetit të popullit “që Shqipëria me sot të bëhet në vehte, e lirë e e mosvarme”.. (sipas Revistës “Flamuri” të publikuar në korrik-Shëndre 1952, nr. 31-36, faqe 3, në Romë; si dhe “Besë”, nânduer 1954, nr. 15, Istanbul (Constantinople). Është fakt historik se, ligjërimi 5-minutësh i Ismail Qemalit në pasditen e 28 Nëntorit 1912, Vlorë, përmbante 450 fjalë. Ndërprerja më e gjatë e fjalimit të Ismail Qemalit është në momentin që ai nxjerr flamurin dhe e valëvit atë në ajër dhe thotë “Rroftë Shqipëria e Lirë!” dhe ndërkohë Pavarësia e Ismail Qemalit përfshinte të gjitha trevat shqiptare, Kosova, shqiptarët e Maqedonisë, Çamëria dhe pjesa e shqiptarëve, që u shkëput më vonë nga Mali i Zi.

Rrugëtimi historik i Ismail Qemalit dhe pavarësisë në 4122 km



SHQIPTARËT & TROJET SHQIPTARE: “TË LIRË TË PAVARUR DHE MËVEHTE...!”

Ja ligjërata e tij me flamur në dorë menjëherë pasi ishte nënshkruar pavarësia: “Vëllezër shqiptarë! Oh! Sa të lumtur që e ndiej vehten sot, që shoh, këtu në Vlorë, kaqë burra Shqiptarë të mbledhur tok, tute pritur me kureshti e padurim përfundimin e kësaj mbledhjeje historike, për fatin e Atdheut tonë të dashur. Plot me gaz e me lot ndër sy, nga mallëngjimi, pra, po dal këtu para jush që t’ju gëzoj me sihariqin e madh, se sot, edhe këtë minutë, Kongresi çpalli mëvetësinë e Shqipërisë, duke lajmëruar gjithë botën mbarë për këtë punë e duke më ngarkuar mua kryesin’ e qeveris së përkohshme të Shqipërisë së lirë.

Porsi ëndërr më duket ky ndryshim i madh i vendit t’onë, që hoqi e voi të zezat e të lirit pesëqind vjet me radhë ndënë sundimin turk, por që tani në kohët e fundit, ishte gati të jepte shpirtin përgjithënjë, të shuhej e të çfarrosej krejtësisht nga faqia e dheut, këjo Shqipëri, që, dikur, shkëlqente nga trimëria e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri, që kur i kërcënohej rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t’egër që ka pas Turqija. Mirëpo, desh Zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoq të Shqiptarëvevet, sot e tutje të marrin fund mjerimet dhe vuajtjet e Atdheut t’onë, sepse, këtu e kështu, jemi të lirë të pavarur dhe mëvehte, prandaj: qeshni e gëzoni!

Për t’ia arrijtur kësaj dite të bardhë e të madhe, na ka ndihmuar gjaku i dëshmorëvevet dhe puna e vlefshme e patriotëve t’anë dhe e të gjithë shokëve që muarrnë pjesë në këtë mbledhje dhe e të gjithë juve, që tani po ju gufon zemëra nga gazi i madh që ndieni; mirëpo mbledhja si më plak që jam, m’a ngarkoi mua Ngritjen e shënjtë të shënjës t’onë Kombëtare, të flamurit t’onë të ëndërruar e të dashur (nxjerr Flamurin, të cilin e ka të vendosur në një shtizë hekurit, natyrisht të vogël, dhe të pshehur nën pallto dhe pasi e mba një sekondë në dorë e ngul në shtyllat e ballkonit. Shqiptarët, posa e shohin Flamurin thërrasin me gëzim e me zë të lartë: Rroftë Flamuri, Rroftë Shqipëria e Lirë). Ja, pra, ky është Flamuri Ynë i kuq e me shqiponjën dykrenare të zezë në mest. Dhe tani, të gjithë bashkë, si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për t’a mburuar, për t’a përparuar e për t’a qytetëruar si i ka hije Atdhenë t’onë të Lirë. Tuke përfunduar, s’më mbetet gjë, veçse t’i drejtoj një lutje Zotit të Madh, që, bashkë me bekimet e Tij që i lipij të na japë për të qenë të denjë të kësaj dite, të pranojë që këtej e tutje të jem unë dëshmorit më i parë i Atdheut, ashtu siç pata nderin dhe fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valvitet i Lirë. Flamuri i ynë, n’atdhenë t’onë të lirë. Rroftë Flamuri! Rroftë Shqipëria!”. (Sipas origjinalit në AQSH, Fondi dokumentar 245/II, Dosja 1. faqe 43; si dhe libri “Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh) 1888 – 1919”, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, faqe 231-232). Kabineti i qeverisë së Vlorës është i dokumentuar në këtë mënyrë: Kryeministër dhe ministër i jashtëm: Ismail Qemali; Zëvendëskryeministër Nikoll Kaçorri, më vonë Ministër i Jashtëm Myfit Libohova, Ministër i Luftës Mehmet Pashë Dërralla, Ministër i Drejtësisë Petro Poga, Ministër i Arsimit Luigj Gurakuqi, Ministër i Financave Abdi Toptani, Ministër i Bujqësisë Pandeli Cale, Ministër i Post Telegrafit Lef Nosi.

FJALËARTI ISMAIL QEMALI DHE FLAMURI I SHQIPËRISË SË LIRË

Pas shpalljes së mëvetësisë, përpjekjet 14 mujore të qeverisë së parë të përkohshme nuk reshtën në kushtet tejet të vështira, por në kujtesën e kombit nuk harrohen fjalët e Ismail Qemalit për Kosovën kreshnike dhe krejt Shqipërinë e përbashkuar në një shtet të vetëm dhe të unifikuar. Është pikërisht ligjërata e babait të kombit, Ismail Qemali në Vlorë në tetorin e vitit 1913, që shprehej: “Zotërinj! Ju lutem të më ndjeni që ju bëra të më prisni por kam për t’ju thënë një lajm të mirë që ma solli zoti koshull/konsull i Austro-Hungarisë, me të cilin fola gjer tani. Ky lajm do ta shpërblejë mundin që muarrtë të prisnin gjer tani. Zoti Kushull më lajmëroi se, Serbët u hoqën nga të gjitha viset që kishin zënë kohët e fundit edhe këto ditë do të hiqen nga ato nja dy vise ku gjenden akoma. Kam shpresë që për së shpejti do t’u jap edhe një lajm të mirë që Grekët u hoqën nga viset të vendosura t’i mbesin Shqipërisë. Kërkova të piqem me ju edhe t’ju thom se ç’bëri e ç’ nuk bëri qeverija gjer më ditën e sotme edhe përse u banë disa vepra të cilat ndofta nuk duheshin të ishin bërë. Tani mbushen njëmbëdhjetë muaj që kur se po rrojmë nën hijen e flamurit të Shqipërisë së lirë. Sot e një mot, kur të huajt i shkelën të gjitha viset e Shqipërisë, po thua, pa kurrë farë kundërshtimi, neve të bijve të këtij vendi, nuk na kishte mbetur veçse një detyrë; të përpiqemi për të formuar një qeveri, e cila duke i mbajtur të lira viset që nuk kishin rënë akoma nën pushtetin e të huajve, të përpiqemi e të ngrejmë zërin tonë për shpëtimin e viseve të tjera e për të drejtat e Kombit Shqiptar”. Fjalë-arti, plaku i bardhë i flamurit e donte Shqipërinë përtej kufijve të “Shqipërisë londineze”, në kufijtë që kërkonte që në prillin e 1913-tës, në kryeqendrat e kancelarije europiane.

DOKUMENTI I PAVARËSISË SHQIPTARE DHE FIRMËTARËT E PAVARËSISË

Dokumenti i pavarësisë është ekspozuar për herë të parë në nëntor 1937 me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, fotografuar nga Marubi. Revista e përmuajshme “Përpjekja shqiptare”, nr.13, datë 13.1.1938, fq 52 (Kapitulli “jeta dhe librat”); rol në ruajtjen e dokumentit ka luajtur Lef Nosi, anëtar i kuvendit të Vlorës dhe ministër në qeverinë e Ismail Qemalit; dhe që ky dokument ka qenë ruajtur në një nga kasafortat e Bankës së Shqipërisë, edhe sipas Aleksandër Xhuvanit, por edhe sipas Kristo Frashërit dhe që është sot një mister që shkon deri në vitin 1962, në 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe më tej që ka aludime që duket se nuk po hedhin dritë realisht mbi të vërtetën. Asambleja e Kuvendit të Vlorës prej 40 delegatëve në qytetin e Vlorës, më 28 nëntor 1912, hartoi një procesverbal, ku u radhitën firmat e të dërguarve të përzgjedhur delegatë të kuvendit kombëtar të Vlorës. Dokumenti u diktua nga Ismail Qemal bej Vlora, u shkrua në shqip nga Luigj Gurakuqi dhe në osmanllisht nga Shefqet Dajuti. Teksti i procesverbalit ka këtë përmbajtje: “Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë 1328/1912, pas fjalëvevet që tha z. Kryetar Ismail Kemal beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zë venduan që Shqipëria më sot të bëhet në vehte, e lirë e e mosvarme”. Pasi u përmendën prej Ismail Qemal Beut Kryetarit të Kongresit, rreziqet e mjerimit në të cilat ndodhet Shqipnia, kongresistët me nji zë pranuan Independencën edhe e proklamuan Shqipniën Shtet Independent e të lirë.

Nënshkruesit e deklaratës së Pavarësisë janë: Ismail Kemal bej Vlora (1844 -1919); Dom Nikoll Kaçorri (1862-1917); Vehbi Dibra Agolli (1867-1937); Jorgji Karbunara – Babë Dudë Karbunara (1842-1917); Elmas Boce (1852-1925); Veli Harçi (1850-1914); Qazim Kokoshi (1882-1945); Jani Minga (1872-1947); Rexhep Mitrovica (1888-1960); Dhimitër Tutulani (1875-1937); Aristidh Ruçi (1875-1950); Abdi Toptani (1864-1942); Abas Dilaver Celkupa (1855-1926); Mit’hat Frashëri (1880-1949); Shefqet Dajuti (1882-1946); Zihni Abas Kanina Hamzaraj (1885-1957); Xhelal Koprëncka (1782-1919); Hajredin Cakrani (1860-1942); Qemal Karaosmani Elbasani (1875-1949); Iljaz Vrioni (1882-1932); Sali Gjuka (1876-1925); Dhimitër Beratti (1888-1970); Dhimitër Mborja Emanoil (1884-1945); Dhimitër Zografi (1878-1947); Murad Toptani (1867-1918); Pandeli Cale (1879-1923); Luigj Gurakuqi (1879-1925); Bedri Pejani (1885-1946); Spiridon Ilo (1876-1950); Thanas Floqi (1884-1945); Qemal Mullaj (1881-1966); Lef Nosi (1873-1946); Dr. Hafiz Myrteza Ali Struga; Nuri Sojliu (1870-1940); Mustafa Merlika Kruja (1887-1958); Ferit Vokopola (1887-1969); Ymer Deliallisi (1873-1944); Xhemal Deliallisi (1880-1941); Nebi Sefa (1861-1942); Zyhdhi Ohri (1872-1938). Ndërsa më 1962 përvjetorin e 50-të të shpalljes së Pavarësisë, Nexhip Pelivan Alban (nga Zhulati i Gjirokastresë), botoi në Turqi librin “Arnautlugun Bagimsizligi ve Avlonyali Ismail Kemal” (Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë...), ku në faqen 24, Nexhip Alban ka përkthyer shkrimin në osmanllisht që thotë se në dokumentin “Dokumenti i shpalljes së Pavarësisë” dhe përfundoi katër rreshta në turqisht: “Ismail Qemal Beu, kryetar i Kongresit (Kuvendit) deklaroi rreziqet e mjerimit ku ndodhej Shqipëria dhe kongresistët pranuan me një zë independencën dhe proklamuan Shqipërinë shtet independent e të lirë”.



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

Gjenerali Dwight D. Eisenhower e përshkroi rëndësinë e logjistikës: «Nuk do ta keni të vështirë të provoni se betejat, fushatat dhe madje edhe luftërat janë fituar ose humbur kryesisht për shkak të logjistikës» ndërsa Gjeneral Omar N. Bradley ka thënë “Amatorët flasin për strategji, ndërsa profesionistët vetëm për logjistikë”. Kaq mjafton nga historiku i luftës, për të analizuar të ardhmen e logjistikës në një konflikt të armatosur.

Inteligjenca artificiale (IA) mund të përdorë sisteme ushtarake si Sistemi i Mbështetjes së Vendimeve Globale dhe Shërbimet e Zonës Funktionale të Logjistikës. Kjo analizë gjithëpërfshirëse e të dhënave të vendimmarrjes më të informuar dhe operacione logjistike efikase. Ky informacion mund të krijojë një pamje gjithëpërfshirëse të mjedisit operacional, duke i lejuar komandantët të marrin vendime të informuara në kohë reale.

Përderisa Inteligenca Artificiale në logjistikën e Ushtrisë do të jetë e mundur, rezultojnë disa integritime të rëndësishme dhe disavantazhe të tjera për t'u marrë parasysh. Disa kritikë argumentojnë se mbështetja në IA mund të çojë në mbitheksimin e teknologjisë në kurriz të problemeve njerëzore dhe intuitës (imajinatës), të cilat janë në situata komplekse të paparashikueshme. Ekziston rreziku që IA mund të krijojë një ndjenjë të rreme sigurie, duke çuar në besim të tepëruar dhe si rezultat një vendimarrje të gabuar strategjike.

Logjistika në ushtri përfshin më shumë funksione sesa mendojnë shumica e njerëzve. Në luftën moderne, kjo do të thotë sasi të mëdha të dhënash për të analizuar në mënyrë që të merren vendime në lidhje me furnizimin, transportin, komunikimin, e kështu me radhë. Inteligenca Artificiale mund të adresojë shumë sfida të logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit, duke përfshirë edhe rrugën e automjeteve. Inteligenca artificiale po krijon mundësi të reja të pashembullta për menaxhimin e logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit. Megjithatë, shumë organizata mbeten të pasigurta për mënyrën më të mirë për ta zbatuar atë. Përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) dhe mësimit të makinerive (Logjistika e FA) në një ose më shumë fusha në logjistikë mund të ndihmojë në përshpejtimin e këtij procesi dhe ta bëjë atë më të shkathët. IA dhe LU mund të kenë përfitime të mëdha për logjistikën ushtarake, ushtria është fokusuar në aplikimet e IA dhe LU në fusha të tjera. FA ka qenë e ngadaltë në përvetësim dhe shpesh pranon një status të thjeshtë për logjistikën e saj në zonat aktive të luftës. Sidoqoftë, integrimi i IA-së për logjistikën në ushtri vjen me shqetësimet e veta shoqëruese, megjithëse ato nuk janë të njëjta me ato kur përdoret IA për mbikëqyrje, inteligjencë ose armësh.

Çështjet me IA-në për logjistikën kanë të bëjnë me paparashikueshmërinë e natyrshme dhe cenueshmërinë ndaj shfrytëzimit. Fakti që kundërshtarët më të mëdhenj të SHBA-së po ndjekin në mënyrë agresive përdorimin e IA-së dhe ML-së në sistemet e tyre të mbrojtjes, dhe se të njëjtat sisteme përballen me të njëjtat rreze dhe dobësi, mund të paraqesë mundësi unike për Departamentin e Mbrojtjes (DoD) për të niveluar fushën e lojës. Sido që të jetë, DoD në SHBA po trajton çështjen e përdorimit të IA-së për logjistikë në ushtrinë amerikane, e kryesuar nga Qendra e Përbashkët e Inteligjencës Artificiale e sapoformuar e quajtur (JAIC). Autorët e “Përmbledhjes së Strategjisë së Inteligjencës Artificiale të Departamentit të Mbrojtjes 2018” theksojnë se “kombet e tjera, veçanërisht Kina dhe Rusia, po bëjnë investime të rëndësishme në IA-në për qëllime ushtarake.

Ndihma e menjëhershme mjekësore nuk është gjithmonë e disponueshme në fushën e betejës. Mund të jetë mungesa e mjekëve aktualë në zonë, lëndime përtej aftësive të një mjeku, ose çështje triazhi, ku personeli mjekësor i jep përparësi të lënduarve më keq. IA mund të japë disa përgjigje në këtë fushë të logjistikës. Inteligenca artificiale në mjekësi është një fushë e mirëpërcaktuar në sektorin tregtar, por jo aq shumë në ushtri. Përpjekjet janë duke u zhvilluar për të korrigjuar këtë çekuilibër, me Qendrën e Kërkimit të Telemjekësisë dhe Teknologjisë së Avancuar të Ushtrisë (TATRC) që drejton akuzën.

E ardhmja e logjistikës drejt përdorimit të inteligjencës artificiale (AI)



LOGJISTIKA NË USHTRI PËRFSHIN MË SHUMË FUNKSIONE SESA MENDOJNË SHUMICA E NJERËZVE. NË LUFTËN MODERNE, KJO DO TË THOTË SASI TË MËDHA TË DHËNASH PËR TË ANALIZUAR NË MËNYRË QË TË MERREN VENDIME NË LIDHJE ME FURNIZIMIN, TRANSPORTIN, KOMUNIKIMIN, E KËSHTU ME RADHË. INTELIGJENCA ARTIFICIALE MUND TË ADRESOJË SHUMË SFIDA TË LOGJISTIKËS DHE ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT, DUKE PËRFSHIRË EDHE RRUGËN E AUTOMJETEVE. INTELIGJENCA ARTIFICIALE PO KRIJON MUNDËSI TË REJA TË PASHEMBULLTA PËR MENAXHIMIN E LOGJISTIKËS DHE ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT.

I quajtur sistemi i Automated Ruggedized Combat Casualty Care (ARC3), ai nuk do të jetë një IA mjekësore plotësisht e automatizuar, por më tepër softuer që mund të ndihmojë mjekët në diagnostikimin e lëndimeve, monitorimin e pacientëve dhe ofrimin e trajtimit kur evakuimi i menjëhershëm i pacientit nuk është i mundur. Sistemi është aktualisht në zhvillim e sipër. Charles River gjithashtu lidhi një kontratë për të zhvilluar aplikacionin celular “Ansamble Prediction for Combat Casualty Care” (EPIC3). Ideja është t'i sigurohet mjekut një mbështetje vendimtare, kur bëhet fjalë për trajtimin e lëndimeve traumatike. EPIC3 supozohet se paraqet hapat për të trajtuar ato lëndime përmes një ndërfaqe të thjeshtë dhe të lehtë për t'u përdorur, që përshtatet me nevojat dhe nivelin e aftësive të përdoruesit. Ky softuer është gjithashtu në zhvillim e sipër.

“AthenaGTX” pretendoi se është në fazat e fundit të zhvillimit të bazuar për Sistemin e tij të Kujdesit Kritik të Automatizuar (ACCS).

Kompania e përshkroi atë si një “sistem sistemesh” që “integronë monitorimin fiziologjik të pacientit me ndërhyrjet e kontrolluara nga algoritmet e softuerit për të ofruar kujdes mjekësor automatik për luftëtarët e plagosur rëndë”. Kompania gjithashtu ka një pajisje të veshur që pretendon se mund të ndihmojë në kontrollimin e fushëbetesës. I quajtur “Wireless Vital Signs Monitor” (WVSM), ai regjistron gjërat vitale të një pacienti dhe e transmeton atë në pajisje të përputhshme.

Një databazë qendrore informacioni mund të duket si një ide e keqe për ushtrinë, por në botën e logjistikës, është e nevojshme. Do të thotë kursime në kohë, përpjekje dhe para nëse logjisticienët kanë të gjithë informacionin që u nevojitet për të marrë vendime të informuara kur lëvizin furnizimet dhe pajisjet për të mbështetur trupat. Në përputhje me këtë, IBM ofron shërbime cloud, si dhe akses në “Watson” për të ruajtur dhe përpunuar të dhëna logjistike që



vijnë nga burime të ndryshme. Aktiviteti i Mbështetjes së Logjistikës, ose LOGSA, (tani Qendra e Analizës së të Dhënave Logjistike ose LDCA) si dhe aftësitë si “Watson e bëjnë të jetë një mënyrë për t’i krijuar lehtësira për analistët nga disa punë më teknike, me qëllim për ta lënë makinën (pajisjen) të bëjë një pjesë të kësaj dhe për të shfrytëzuar ekspertizën profesionale të analistëve për të më tej se ku po shkon Ushtria. Ideja është që të përdoret cloud për të ngarkuar të dhënat e sensorëve nga automjetet dhe pajisjet dhe për të kryer “mirëmbajtjen e bazuar në kondicionuar (CBM)”, e cila është një qasje e riparimit kur nevojitet, e mundur me analizën e të dhënave të drejtuar nga AI-ja. Në vitin 2019, ajo iniciativë ka lulëzuar në një kontratë shumë miliardëshe me një ofrues të vetëm për ruajtje të sigurt cloud dhe softuer nën Infrastrukturrën e Mbrojtjes së Ndërmarrjeve të Përbashkëta (JEDI) me disa kompani tregtare që konkurrojnë për të.

Për Agjencinë e Logjistikës së Mbrojtjes (DLA), ky është një problem i madh, pasi siguron atë që i nevojitet ushtrisë, si armë, pjesë riparimi dhe karburant, si dhe asgjëson pajisjet e tepërta. Duke qenë se DLA merr mesatarisht një milion oferta në ditë, mund të jetë fatalisht e lehtë për t’u realizuar disa transaksione të dyshimta. Për të adresuar këtë çështje, DLA iu drejtua softuerit IA dhe ML për të renditur malin e të dhënave private dhe publike për të identifikuar dhe shënuar furnizuesit e dyshimtë ose anormalë.

